



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 3.6.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Arbër Limani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajšhori (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Arbnora Ajeti (PDK), Amir Simnica (LDK), Violeta Salihu (LVV), Driton Rukiqi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK) dhe Sami Salihu (LDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Jehona Lushaku, nënkryetare e Komunës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Donjeta Dragusha, drejtore e Zhvillimit Rural, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të banorëve të lagjes “Kalabria” dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.
Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ky

Faqe 1 nga 8

Rend i ditës:

1. Propozim-vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kalabria" 2024-2032, në Prishtinë.

Para se të fillonin me diskutimin e pikës së rendit të ditës, **Gëzim Sveçla** kërkoi që të votohet për shmangëje nga Rregulloja e punës së Kuvendit, në mënyrë që secilit asamblistë t'i mundësohet të flasë aq sa ka nevojë për ta trajtuar këtë propozim-vendim.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 4 abstenime, u miratua kërkesa e z. Sveçla për shmangëje nga Rregullorja e punës së Kuvendit.

Arsyeshmërinë për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kalabria" 2024-2032, në Prishtinë, para të pranishmëve e paraqiti Arber Sadiku, drejtor.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Gëzim Sveçla tha se, prej muajit shtator të vitit 2022, që kryetari kishte premtuar se ky plan do të sillej në Kuvend e deri më sot asnjëherë nuk u soll plani i lagjes "Kalabria" në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Për këtë plan rregullues, i kemi dy vërejtje substanciale, të cilat duhet të merren parasysh dhe të inkorporohen në plan, në mënyrë që për hir të banorëve të penalizuar të Kalabrisë, si subjekt politik ta mbështesim. E para, që është pa alternativë, banorëve të cilëve ju është përcaktuar koeficienti 1.5, t'u kthehet në 2.4, siç e ka pasur me planin paraprak. Është fjala përreth 8 ha hapësirë që u përket banorëve më të vjetër të lagjes. Në atë hapësirë janë rreth njëzet familje që nuk i kanë blerë ato prona për tregti, nuk i kanë blerë as në privatizim, por janë banorë që jetojnë aty me dekada, e ndoshta edhe me shekuj. Po ashtu, vërejtja tjetër ka të bëjë me Stacionin e Autobusëve, që me planin e ri është propozuar koeficienti më i madh i mundshëm, dhe ne propozojmë që koeficienti të kthehet ashtu siç ka qenë në planin paraprak, 2.4. Po ashtu, propozojmë që stacioni i autobusëve të largohet nga plani për lagjen "Kalabria" dhe të trajtohet më vonë, kur të kemi plan konkret ndaras si plan i veçantë vetëm për Stacionin.

Duke pasur për bazë të gjitha këto që u cekën, ne duam të vendosim kritere që ndihmojnë në zhvillimin e lagjes, që mundësojnë jetë cilësore për banorët dhe, në të njëjtën kohë, e mbrojmë pronën publike si pasuri e jona e përbashkët.

Jeta Rafuna tha se qytetarët e kësaj lagjeje me të drejtë kanë kërkuar që ky plan të finalizohet dhe i njëjti të miratohet, me qëllim që zhvillimi urbanistik i kësaj lagjeje të bëhet sipas planit të ri, i cili do t'ia mundësojë kësaj lagjeje zhvillim urbanistik normal. "Kalabria" me këtë plan do të ruhet nga betoni, do të krijohen hapësira të gjelbra dhe janë planifikuar hapësira të mjaftueshme për shkolla e çerdhe të reja, të cilat kanë impakt të

drejtpërdrejtë në jetën dhe sigurinë e qytetarëve të kësaj lagjeje, ku kjo lagje do të ndërlidhet edhe me pjesët e tjera të kryeqytetit. Besoj se në këtë plan prona publike duhet të trajtohet në atë mënyrë që asaj t'i rritet vlera ashtu siç e përcakton edhe ligji, prandaj si grup parlamentar në pajtim me të gjitha çështjet e theksuara më lart për interes të qytetarëve dhe zhvillimit të Kalabrisë, do të votojë pro këtij plani, me shpresë që i njëjti mund të plotësohet më tutje në procesin e hartimit të hartave zonale pas miratimit të Planit zhvillimor komunal të Prishtinës.

Leutrim Retkoceri theksoi se neve këtu na është paraqitë një plan në vija të trasha, në betonizim të lagjes në koeficientin 7 në pronat publike, dhe kjo nuk ka qenë asnjëherë pikë diskutimi, të kthehet prona publike në ndërtim të lartë, asnjëherë nuk është prezantuar. Ndryshimi substancial i këtij plani që na është prezantuar dhe plani që ka qenë i anuluar, është dhënia e pronave publike për ndërtim. Pra është një pabarazinë, e cila ka vazhduar në këtë plan në dallim në lartësi të ndërtimit, e kjo nuk ka qenë ideja, sepse plani i kaluar ka qenë që koeficient i ndërtimit të jet 2.4 dhe të trajtohen të gjithë të barabartë. Pritjet kanë qenë që të rritet infrastruktura publike, të harmonizohet me premtimin që e ka bërë kryetari, se koeficienti 2.4 nuk e zë këtë infrastrukturë publike. Gjithashtu, sipas këtij plani shihet se ka zvogëlim të hapësirës së gjelbër. Duhet pasur parasysh se prona publike është e të gjithë qytetarëve dhe duhet me iu dhënë në dispozicion banorëve të lagjes. Inkurajojmë kryetarin që ta marrë guximin ta ndryshoj këtë plan, ti largojë pronat publike prej ndërtimit, pasi që prona publike nuk është e një individi, ajo është e të gjithë qytetarëve të Prishtinës.

Kushtrim Mushica tha se ne si grup i Aleancës nuk jemi të interesuar me bllokuar Kalabrinë, përkundrazi kemi qenë zëri i tyre për të ardhur deri te kjo seancë, që vendoset për të ardhmen e kësaj pjese të rëndësishme të qytetit. Ne për këtë plan i kemi disa vërejtje.

Stacioni i Autobusëve ka një koeficient të ndërtimit maksimal, ndërsa ka prona private që iu ka mbetur koeficienti i ulët, kështu që mendojm se kjo nuk qëndron. Po ashtu, dyndjet e betonimit në raport me gjelbërimin e me hapësira, si ato sportive, rekreative për çerdhet dhe shkollat dhe të ndryshme, janë tejet të zvogëluara, andaj do të ishte mirë që këto vërejtje të merren parasysh dhe të harmonizohen në këtë plan.

Sami Borovci tha se ky plan i kësaj lagjeje po na përcjell jo prej këtij mandati por edhe në të kaluarën, një lagje e kemi lënë pa perspektivë, e kemi lënë mbrapa, mirëpo po besoj shumë që ka ardhë koha dhe ka ardhur momenti që më në fund kjo lagje të zhbllokohet. Vërejtjet për këtë plan kanë të bëjë me pjesën e koeficienteve, andaj propozoi që, pjesa e koeficienteve që ka mbetur me 1.5 të bëhet në 2.4, gjithashtu edhe një pjesë që ka qenë 1.8, po ashtu të bëhet në 2.4.

Mendoj se do të ishte mirë që, kryetari me shefat e grupeve parlamentare, ta bëjnë një

diskutim me qëllim që të gjitha këto propozime, këto vërejtje me i harmonizuar dhe së bashku me ardhur në një përfundim që me kaluar këtë plan.

Gëzim Mehmeti rikujtoi se kur është anuluar ky plan, në vitin 2022, me kërkesën e këtij ekzekutivi, në këtë Kuvend janë paraqitur dy arsye kryesore, sepse MMPH e ka kthyer të jashtëligjshëm, ka qenë arsyeja e parë, ndërsa arsyeja e dytë ka qenë, sepse ekzekutivi në krye me kryetarin, kanë premtuar se plani i ri do të ketë më shumë hapësira publike, më shumë gjelbërim, më shumë institucione publike dhe që është më e rëndësishme do të avancohet parimi i barabarësisë ndaj qytetarëve të kësaj lagjeje sa i përket mundësisë së ndërtimit në pronat individuale në këtë zonë dhe, megjithatë është për të ardhur keq që nuk janë mbajtur premtimet e bëra publike për këto çështje thelbësore. Ky plan që na është prezantuar sot, shihet se është tentimi për rritje enorme të koeficientëve në pronat publike, nga 1.8 në 7 dhe kjo është arsyeja pse tash po dëshmohej pse është anuluar dhe ne për dy vjet i kemi maltretuar qytetarët e lagjes "Kalabria" rreth të drejtave të tyre në ndërtim dhe të drejtave individuale.

Kërkoj nga kryetari të dijë arsyen, pse po insistohet që koeficienti 7 të mbetet në Stacionin e Autobusëve me çdo kusht. Ky plan që na është prezantuar jo vetëm që e dëmton interesin e qytetarëve, por minon edhe besimin në institucionet e shtetit të Kosovës dhe procesin e planifikimit urban që është shumë me rëndësi. Loja me koeficienta është një veprim i papranueshëm, që dëmton në masë të madhe zhvillimin dhe të drejtën e qëndrueshme të kryeqytetit tonë. Kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që kësaj radhe të veprojnë denjësisht, siç kërkon pozita e tyre, dhe të fokusohemi vetëm te interesat e qytetarëve që ndërlidhen me planin rregullues.

Endrit Zabërgja u shpreh se duke pasur parasysh që shumë seanca kanë kaluar, e dinë edhe banorët që kemi bërë edhe pyetje parlamentare, ashtu siç ata na janë drejtuar në komunikimin tonë direkt që i kemi me qytetarët në platformat sociale, dhe kemi vazhduar gjithmonë në paraqitjen e këtyre kërkesave, andaj sot është një rast i mirë, një mundësi e mirë që këta banorë këtu ta kenë më në fund planin e tyre. Besoj se kjo temë duhet të tejkalohet përtej kornizave politike e partiake, duke e pasur parasysh se duhet të kthehemi në një çështje përmbajtjesore, kryesisht te një konsensusi të përgjithshëm, sepse jemi duke e parë që vetëm përmes një konsensusi mund ta zgjidhim këtë çështje. Është më se e rëndësishme sesa gjithçka tjetër barazia mes pronave, mes qytetarëve, mes qytetarëve dhe fqinjëve në atë zonë, duke pasur parasysh të drejtën elementare të qytetarëve për ta shfrytëzuar pronën e vetë në mënyrë të barabartë, andaj për hirë të banorëve, për hirë të përgjegjësisë që e kemi ndaj qytetarëve, lus të gjithë që të gjejmë sot konsensusin e përbashkët, në mënyrë që këta banorë të kenë të drejtën elementare njerëzore në shfrytëzimin e pronës së tyre private.

Fiknete Bejta tha se ne sot këtu në Kuvend po e zbatojmë një kërkesë të kamotshme të qytetarëve të lagjes "Kalabria", dhe në të njëjtën kohë jam e lumtur që me planin e ri asnjë

qytetari të lagjes "Kalabria" nuk do t'i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pronës së tij për ndërtim. Konsideroj se vizioni i kryetarit për këtë plan është se ky vizion të realizohet përmes fuqizimit ose rritjes së vlerës së tokës publike, dhe kjo është njëra prej detyrave të një kryetari të komunës, administrimi i pronës publike dhe rritja e vlerës së saj.

Ky është plan ideal, andaj ju bëjë thirrje gjithë anëtarëve të Kuvendit që të votojnë këtë plan dhe të përmbushim një kërkesë të qytetarëve që është kërkesë legjitime.

Gresa Lahu tha se sipas këtij plani që na është prezantuar, shihet se kryetari ka zgjeruar hapësirën publike në mendësi të asaj se prona publike duhet të rritet dhe të jetë më e vlefshme, ndërkohë që ka betonuar dhe ka ngritëur në 7 koeficientin edhe të hapësirave publike. Realisht, jo se ka qenë plani më i mirë plani i kaluar, por ka qenë shumë herë më i mirë sesa ky që nuk është as plan i detajuar, për ata të cilët mund të bëjnë krahasime. Ndiej keqardhje që koeficientet 2.4 që kryetari Rama i ka ulur në 1.8, i ka ulur edhe në 1.5, e ka ulur vlerën e pronës private dhe thirret në emër të pronës publike.

Feim Osmani theksoi se sa i përket këtij plani, janë disa çështje të cilat për mua këtë plan e bëjnë të parealizueshëm dhe natyrisht, meqë është i parealizueshëm, do duhej të ishte edhe i pavotuar sot, sepse në krahasim me planin e keq që ishte atëherë, janë rritur metrat katrorë të ndërtimit për afërsisht gjashtëqind mijë metra katrorë dhe me gjithë rritjen e këtyre metrave katrorë, nuk është paraparë që të rriten edhe në aspektin tjetër të funksionalizimit të qytetit, siç janë: rrugët, parqet, pastaj hapësirat për institucione tjera publike dhe gjithë infrastruktura përcjellëse, e që ky plan do duhej të shqyrtohej më shumë brenda këtyre dy vite e gjysmë. Konsideroj se është shqetësuese që një park me dymbëdhjetë hektarë, i cili po synohet të bëhet në pronën private, dhe pastaj një ndërtim në pronën publike, mendoj se duhet të bëhet një revidim total i këtij plani. Duke pasur për bazë këto çështje, ne sot duhet të rezonojmë, t'i marrim parasysh interesin e qytetarëve, mirëpo edhe politikën afatgjatë të zhvillimit të Prishtinës dhe të mos krijojmë probleme të cilat nuk do të mund t'i sanojmë asnjëherë në të ardhmen.

Hafiz Krasniqi u shpreh se edhe ne si Grup parlamentar i kemi pasur vërejtjet pikërisht te koeficienti 1.8 dhe 1.5. Mendoj se asnjë qytetar në Kalabri nuk do të ndjehet keq në qoftë se ne sot e votojmë me koeficientin 2.4. Në një parcelë që ka të bëjë me hektarë, aty ku kërkohet zhvillim, aty ku kërkohet infrastrukturë, dhe kërkohet gjithçka që i jep qytetit një pamje të jashtëzakonshme, kjo formë po kundërshtohet, kështu që ne duhet ta mundësojmë zhvillimin e Komunës së Prishtinës me koeficientin e pronave publike, me koeficientin e ndërtimit 7.

Kumrie Shabani, lidhur me këtë plan kërkoi të dijë nga kryetari arsyen se pse nuk janë marrë parasysh dëgjimet publike të gjithë qytetarëve të lagjes "Kalabria", ku pjesa më e madhe e hapësirave të gjelbra shtrihet në pronat private. Pse nuk është bërë një plan i mirëfillt, ku do të parashiheshin hapësira për çerdhe, shkolla qendra të Mjekësisë

Familajere etj., ku do të ishin të kënaqur të gjithë banorët e asaj zone dhe i cili iu kishte konvencuar të gjithëve, edhe pse nuk ka barazi të koeficientëve në këtë lagje. Kërkoj nga kryetari që të bëhen ndryshime, të largohet koeficienti 7 dhe pas këtyre ndryshimeve, ne do ta votojmë këtë plan rregullues.

Arianit Beqiri tha se Stacioni i Autobusëve është sot njëra prej objekteve, të cilat ekzistojnë ende mundësia me e ruajtur si memorie kolektive. Brenda kësaj çështjeje janë dy pika, të cilat ne po besojmë që janë shumë të rëndësishme, dhe është që një koeficient të kthehet ashtu siç ka qenë tek Stacioni i Autobusëve në 2.4, ose le të kthehet në një moment tjetër që diskutojmë edhe më konkretisht për këtë. Mendoj që Stacioni i Autobusëve mund të përdoret në të mirë të Stacionit dhe koeficienti 7 e rrezikon ndjeshëm që kjo mos të mbetet më si simbol i kryeqytetit. Ashtu siç e ceku z. Sveçla në fillim të diskutimit, i cili na përfaqëson njëzëri të gjithë neve grupin tonë të asamblesëve, kërkoj në emër të grupit që në këtë vend dhe në lagje të jetë koeficienti i ndërtimit 2.4. Duke pasur për bazë këto, kërkojmë ose të bëhet stacioni i autobusëve me koeficient 2.4, ose të hiqet nga votimi dhe banorëve të kësaj lagjeje t'u bëhet koeficienti i ndërtimit 2.4.

Nora Kelmendi tha se ky plan nuk është plan i hollësishëm rregullues i cili bazohet në parimin e demokracisë, pjesëmarrjes dhe i cili është përpiluar për një interes të përbashkët të banorëve të kësaj lagjeje, pasi që planet e hollësishme rregulluese bëhen përmes pjesëmarrjes publike dhe merren parasysh të gjitha kërkesat e qytetarëve, e jo vetëm kërkesat e disa individëve. Si një problem që vlen të theksohet në këtë plan, janë edhe disa lagje në zonën kadastrale të Çagllavicës dhe të Prishtinës, dhe për këtë kërkoj një sqarim nga kryetari. Po ashtu, kërkoj të dijë nga kryetari arsyen, pse në Stacionin e Autobusëve duhet të jetë koeficienti 7, e që ky koeficient është edhe në kundërshtim me PSHK-në. Do të ishte mirë që këto hapësira të përbashkëta t'i bëni për banorë e jo t'i betonizoni këto sipërfaqe, siç është rasti me Stacionet e Autobusëve me ndërtime të larta, me koeficient 7. Prishtina ka nevojë për një stacion të autobusëve, i cili do të ndërlihet edhe me Stacionin e Trenit e jo me ndërtime të larta.

Triera Kasumi - Berisha u shpreh se ne si asamblistë të këtij mandati marrim vendime për dekada e dekada, të cilat kanë me i përcjellë qytetarët e Prishtinës dhe për të cilat nuk mendoj që duhet me pasur kaq shkurt-pamësi njëjt kur vendosim edhe për pronën publike, e cila i takon qytetarëve dhe jo partive politike, individëve që janë në pushtet e tjerë. Si rezultat, u fol shumë për krejt argumentimet e koeficientit të banorëve, koeficientit të Stacionit të Autobusëve. Për mos me i ngarkuar qytetarët, si bashkëfolësit e grupit tim, kërkoj që nëse ka mundësi menjëherë me qitur në votim për me e larguar temën e diskutimit për koeficientin e pronës publike dhe në një seancë tjetër të jashtëzakonshme, të diskutojmë detajisht për çështjen e koeficientit të pronës publike.

Milazim Vitija tha se në bazë të diskutimeve që u paraqitën për këtë plan rregullues shihet se kontestuese është çështja e pronës shoqërore apo pronës komunale, dhe mednoj

se është e logjikshme që vlera e pronës komunale duhet të vlerësohet dhe duhet të rritet. Jemi për ta votuar këtë plan, jo vetëm këtë plan, por edhe të gjitha planet tjerë urbanistike që qytetarët e Prishtinës janë duke pritur me ankth me i shfrytëzuar pronat e veta.

Bahri Gashi, kërkoi të dijë nga kryetari se me çfar kriteri i keni dëmtuar më se tridhjetë hektarë të parkut "Kalabria" me koeficient 1 dhe a munit që atyre njerëzve me ua barazuar koeficientin me të tjerët dhe të jetë 2.4. Mendoj se është e padrejtë me i dëmtuar ata e kur të tjerët përfitojnë mirë.

Lidhur me vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Arbër Sadiku, drejtor, Përparim Rama, kryetar dhe Fatos Dibra, përfaqësues i Zyres ligjore.

Sami Boroci edhe një herë potencoi, duke shtuar se në grupet parlamentare, përfaqësuesit e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, të uleni, të diskutojmë me qëllim të arritjes së një kompromisi për votimin e këtij plani rregullues.

Me propozimin e z. Boroci, përfaqësuesit e partive politike u pajtuan që të ulen dhe të diskutojnë për të gjitha vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet që u paraqitën nga të gjithë parafolësit.

Pas diskutimeve mes përfaqësuesve të partive politike, **Gëzim Sveçla** u shpreh se, pas shumë diskutimeve kemi arritur në një përfundim, që si pjesë e planit të propozuar t'i bëjmë këto ndryshime:

1. Rritja e koeficientit për banorët nga 1.5 të jetë në 2.4;
2. Hapësirat e gjelbra të kthehen ashtu siç kanë qenë hapësira të gjelbra;
3. Parku Botanika që ka qenë në planin e kaluar, të kthehet ashtu siç ka qenë me koeficientin 1.0;
4. Në hapësirat te Parku i Kalabrisë, koeficienti nga 1, të ngritet në 1.25 dhe
5. Në hapësirat e Stacionit të Autobusëve, koeficienti të jetë 3.0.

Leutrim Ratkoceri tha se në asnjë moment nuk mund të lejojmë edhe të pranojmë që, me gjithë propozimet e pranuar, të ketë ndërtim në pronën publike, konkretisht në hapësirën e Stacionit të Autobusëve. Prona publike është e qytetarëve të Prishtinës dhe e askujt tjetër.

Për këtë çështje propozoj që proceduralisht të votohen ndryshimet dhe propozimi im që pronat publike të hiqet prej ndërtimit në hapësirën e Stacionit të Autobusëve dhe ndërtimi në pronat tjera publike.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Retkoceri, që pronat publike të hiqet prej ndërtimit në hapësirën në Stacionin e Autobusëve dhe ndërtimi në pronat tjera publike.

Kryesuesi konstatoi se më 6 vota për dhe 18 vota kundër, nuk u miratua propozimi i z. Retkoceri.

GP i PDK-së, në shenjë paknaqësie për mosmiratimin e propozimit të z. Retkoceri, e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë gjithësej 26 anëtarë të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, dhe me propozimet e z. Sveçla për plotësim-ndryshimin e këtij plani, u miratua Vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Kalabria" 2024-2032, në Prishtinë.

Mbledhja përfundoi në orën 19:30.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina



Faqe8nga8